



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2062/6 prot.

Datë 02.09.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1179/ 2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar    |
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 02.09.2024, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-08245-06-05-2024, me objekt: Loti 3 “*Skaner dhe MRZ Reader*”, me fond limit 7,550,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.06.2024, nga autoriteti kontraktor “Identitek SHA”.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me NIPT J61817047D dhe adresë: Bulevardi “Zhan D’ark”, Nd.32, Hyrja 16, kati 2, Ap.1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Identitek SHA, me adresë: Rruga “Xhanfize Keko”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit

të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-08245-06-05-2024, me objekt: Loti 3 “Skaner dhe MRZ Reader”, me fond limit 7,550,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.06.2024, nga autoriteti kontraktor Identitek SHA.

II.2. Në datën 26.06.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 17.07.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|                                 |                |              |
|---------------------------------|----------------|--------------|
| 1. “BNT ELECTRONICS” SHPK       | 6.340.000 lekë | skualifikuar |
| 2. “ELECTRON ALBANIA 2008” SHPK | 7.200.000 lekë | kualifikuar  |

II.3.1. Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*“Në lidhje me specifikimet teknike të pajisjeve / artikujve, të paraqitur me katalogët përkatës, konstatohen mangësitë / mosplotësimet e mëposhtme:*

**SKANER**

*- Modeli i paraqitur, referuar katalogut, nuk ofrohet me ushqim “power supply”: USB, sic është kërkuar, por me “AC Power:*

*24V / 0.75A” duke mos plotësuar këtë kërkesë teknike të produktit.*

*Sa më sipër, për arsye të mospërmbushjes së specifikimeve teknike si rrjedhojë e konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023*

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo oferte refuzohet.”*

II.4. Në datën 18.07.2024, është publikuar në SPE njoftimi i fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5. Në datën 24.07.2024, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4368, datë 24.07.2024 dhe nr. Protokolli 2062/2024, datë 24.07.2024, e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit konkretisht duke pretenduar: “AK ka kerkuar prokurimin e pajisjes Skaner me keto parametra:

**KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE**

*Tipi Type: CCD ose CIS ose Ekuivalente*

*Formati Format: A4 Rezolucioni*

*Optikal Optical*

*Resolutioni: 600 dpi*

*Thellesia e Gris Grayscale Depth: 16 bit*

*Thellesia e Ngjyrave Color Depth: 48 bit*

*Menyra e Skanimit Scan Mode: Single Pass*

*Vendosja e Materialit Media Feeder Typ: Flatbed*

*Ushqimi Power Supply: USB*

*KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit Interface: High-Speed USB 2.0*

*Kompatibel me Sistemin e Operimit i Compatible O.S.: Win. 10 ose me i ri*

*Drivers + OCR Software: Nuk Specifikohet*

*AKSESORET Ushqyes + Kabull Power Supply + Cordi: Po, USB Cable*

*CD/DVD Drivers and Software: Po*

*Kabull per Komunikimin e te Dhenave Data Cable: (1) USB Cable*

**GARANCIA**

*Periudha e Mbulimit te Garancise Warranty: 1 Vit*

*Ne permbushje te ketyre specifikimeve teknike per kete model pajisje ne kemi ofertuar pajisjen model Plustec OpticSlim 2700 e cila ka parametra me te larta por vetem menyra e karikimit eshte ekuivalente e asaj te kerkuar dhe jo identik sic eshte kerkuar, pra ne vend te ushqim ipower suply: USB, pajisja eshte e ofertuar me AC power: 24V/0.75?*

*Pra sic edhe rezulton me larte, gjykojmë, se duke qene se menyra e karikimit eshte ekuivalente, nuk perben kusht per skualifikimin e nje oferte e cila ploteson dhe eshte me parametra me te larte se sa eshte kerkuar dhe me nje vlere te ofertuar prej 15 % me lire se vlera e ofertes se shpallur fituese ne kete procedure.*

*Ne kete procedure prokurimi AK ka perpiluar kerkesat per tu furnizuar me nje skaner A4 zyre, I cili dukshem eshte per perdorim ne zyrat e reja te Identitek i lidhur sigurisht me nje PC, atje kur ne asnje rast nuk mund te mungoje nje furnizim AC me energji elektrike per cdo pajisje te mundshme zyre pasi sistemi i Identitek dhe cdo pajisje zyre qe Identitek perdor ka nevojë burim energji per te operuar, apo burim energjie per tu lidhur me internet me sistemin qendror. AK nuk ka si qellim furnizimin me skaner portable, pasi ne ket rast do te kishte perdorur edhe standartet TIK te perpiluar nga AKSHI per kete tip pajisje por per nje skaner zyre. Ne nje pajisje te tille parametrat me te rendesishem, ato qe ndikojne drejt per se drejti ne cilesine e dokumentave qe do te skanohen jane:*

**KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE**

*Tipi Type: CCD ose CIS ose Ekuivalente*

*Formati Format: A4*

*Rezolucioni Optikal Optical Resolution: 600 dpi*

*Thellesia e Gris Grayscale Depth: 16 bit*

*Thellësia e Ngjyrave Color Depth: 48 bit*

*Mënyra e Skanimit Scan Mode: Single Pass Vendosja e Materialit Media Feeder Type: Flatbed Skaneri i ofertuar jo vetem ploteson secilen nga keto karakteristika por edhe i tejkalon ato, psh rezolucioni nga 600dpi i kerkuar eshte ofertuar 1200dpi, pra mund te siguroj imazhe te skanuara 2 here me te qarta. Per me teper si edhe vete AK shprehet ne DST, specifikimet teknike te perpiluara jane specifikime minimale. Pra, minimalisht AK ka kerkuar nje skaner qe te kete si menyre karikimi ate DC-pra USB, por per nje skaner zyre kjo nuk mundet te jete arsye per te perjashtuar edhe cdo menyre tjeter karikimi. Ne kete menyre edhe arsyeja e skualifikimit te ofertes sone me arsyetimin se skaneri i ofertuar nuk eshte ofertuar me power supply USB por me AC Power 24V/0.75A eshte jo i drejte.*

*Referuar LPP, neni 92 Shqyrtimi I Ofertave pika 3 e tij parashikon se Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

*Menyra e karikimit të ofertuar është ekuivalente e asaj të kërkuar por gjithsesi le të themi që është një “devijim” i cili në asnjë moment nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara për këtë produkt.*

*Per me teper se pajisja që ne kemi ofertuar është me performance më të lartë se cdo pajisje tjetër e cila ka si mënyrë karikimi atë DC-pra USB. Kjo pasi cdo pajisje me furnizimi atë AC, pra direkt nga rrjeti elektrik është ndryshem me shpejteshi skanimi më të lartë se cdo pajisje tjetër e ngjashem por me furnizim USB.*

*Pajisja e ofertuar Plustek OpticSlim 2700 ofron një shpejteshi skanimi prej vetëm 3 sek për flete, shpejteshi e cila është e paarritshme nga asnjë pajisje tjetër me karikim USB, përfshirë këtu edhe pajisjet që AK ka në përdorim, Canon LiDE 400 dhe Epson Perfection V19, të cilat në rastin më të mirë kanë një shpejteshi 3 herë më të keqe se modeli I ofertuar. Dhe kjo është qartësisht një karakteristike e rëndësishme e cila rrit siguron një proces pune më të shpejtë duke plotësuar kërkesat minimale të skanerit për përdorim zyre, duke i kursyer 15% buxhetit të shtetit.*

*Sjellim në vëmendjen tuaj se një ndër qëllimet kryesore të LPP është të sigurojmë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet. Bashkëngjitur, gjendet Katalogu I pajisjes së ofertuar nga Shoqëria BNT Electronics shpk.*

*Kërkojme: Kualifikimin e ofertës tone e cila plotëson të gjitha kriteret e kualifikimit me vlerën më të ulët.”*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.2062/2 prot., datë 25.07.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të ankimuesit.

II.7. Përmes shkresës me nr. 478/25 prot., datë 29.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 2062/3 prot., datë 31.07.2024 është dërguar në KPP, vendimi nr. 478/24 prot., datë 29.07.2024, i autoritetit kontraktor, mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, i cili ka vendosur refuzimin e ankesës, duke argumentuar: “KSHA pasi e lexoi me kujdes ankesën e paraqitur nga OE “BNT Electronic” ShPK duke i dhënë kujdesin dhe rëndësinë e duhur, si parantezë ju bën me dije se: Identitek Sha është një shoqëri tregtare shqiptare e cila operon në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Kjo kompani operon në ish asetet (Zyrat) e koncesionarit “ALEAT” dhe ka trashëguar një infrastrukturë fizike dhe instalime elektrike aso Tik në të cilat për një periudhë

4 vjeçare në bazë të një marrëveshjeje koncesionare të ratifikuar në parlament nuk kemi të drejtë të bëjmë ndryshime në infrastrukturë pasi sistemi del nga garancia. Sa më sipër shoqëria Identitek Sha është e kushtëzuar në investime dhe pajisje TIK sipas specifikave të ish koncesionarit "ALEAT", pra zgjidhja që JU ofroni për pajisjen skaner me ushqyes AC power 24V 0.75 është e pamundur teknikisht, në të kundërt dalja nga garancia e sistemit të prodhimit ekspozon në risqe të papërballueshme Shtetin Shqiptar. Referuar specifikimeve teknike të pajisjes "SKANER" të publikuara në DST-të e procedurës dhe katalogut me llojin e pajisjes së paraqitur nga operatori ankimues "BNT Electronics" SHPK, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, vlerëson se në specifikimin teknik "Ushqimi - Povver Supply" ka mospërputhje ndërmjet tyre. Në vijim paraqitet specifikimet e kërkuara të krahasuara më specifikimet e pajisjes së ofruar:

| KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE                      |                             |   |
|--|-----------------------------|---|
|  | CCD ose CIS ose Ekuivalente | Modeli I paraqitur nga nga "BNT Electronics" SHPK Plustec OpticSlim |
| Tipi "Type"  |                             |   |
|  |                             |   |
| Formati "Format":                                    | A4                          | ✓   |
| Rezolucioni Optikal "Optical Resolution":            | 600dpi                      | ✓   |
| Thellësia e Grisë "Grayscale Depth":                 | 16 bit                      | ✓   |
| Thellësia e Ngjyrave "Color Depth":                  | 48 bit                      | ✓   |
| Mënyra e Skanimit "Scan Mode":                       | Single Pass                 | ✓   |
| Vendosja e Materialit "Media Feeder Type":           | Flatbed                     | ✓   |
| Ushqimi "Power Supply":                              | USB                         | JO, është AC Power:24V/0.75A  |
| KOMUNIKIMI & MENAXHIMI                               |                             |   |
| Porta e Komunikimit "Interface":                     | High-Speed USB 2.0          | ✓   |
| Kompatibël me Sistemin e Operimit "Compatible O.S.": | Win. 10 ose më i ri         | ✓   |
| "Drivers" + OCR Software:                            | Nuk Specifikohet            | ✓   |
| AKSESORËT  |                             | ✓   |
| Ushqyes + Kabëll "Power Supply + Cord":              | Po, USB Cable               | ✓   |
| CD/DVD Drivers and Software:                         | Po                          | ✓   |
| Kabëll për Komunikimin e të Dhënave "Data Cable":    | (1) USB Cable               | ✓   |
| GARANCIA   |                             |   |
| Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":         | 1 Vit                       | ✓   |

Shoqëria Identitek Sh.a ka kërkuar specifikisht pajisje Skaner me furnizim energjie me anë të kabullit të standardit "USB" për të plotësuar nevojat e përdorimit të kësaj pajisjeje në të gjitha rrethanat e procesit të punës, qofshin ato në zyrat e aplikimit të shoqërisë apo në Stacionet Mobile të Aplikimit. Përdorimi j pajisjeve skaner me mënyrë ushqimi me energji të llojit "AC Power: 24V/ 0.75A" do të kërkonte ndërhyrje në infrastrukturën elektrike ekzistuese të ambienteve të shoqërisë.

Referuar pretendimit të përsëritur së mënyra e furnizimit me energji të pajisjes së ofruar është ekuivalente me atë të kërkuar, ju bëjmë me dije se mënyra e furnizimit me energji nuk është ekuivalente, por një mënyrë alternative, pra e ndryshme, që bic ndesh me specifikimet e kërkuara në DST me të cilat ju jeni pajtuar duke marrë pjesë në procedurën ç prokurimit, me objekt Loti 3 “Skaner dhe MRZ Reader”.

Referuar pretendimit tuaj se nuk janë përdorur standardet TIK të përpiluara nga AKSHI për pajisjen e kërkuar Skaner, ju bëjmë me dije se janë përdorur specifikimet teknike të përpiluara nga AKSHI dhe kjo gjë mund të verifikohet në dokumentin që gjendet në linkun c mëposhtëm: <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Standardet-TIK-2023-2024.pdf> Sa i përket pretendimeve tuaja KSHA mbështetur në legjislacion paraqet argumentet si më poshtë:

Së pari: Sa i përket pretendimit të parë se “Pajisja e ofertuar Plustec OpticSlim 2700 ka parametra me te larta megjithëse mënyra e karikimit të ushqimit nuk eshte USB” KSHA si dhe KVO e cila ka refuzuar ofertën ka vepruar në bazë të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenit 82 pika 2

... Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë:

- i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit, .
- ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit: dhe... Ankimuesi është në kushtet c parashikuara në nenin 82 pika 2 gërma i dhe ii, sa më sipër kjo ankesë nuk mund të pranohet.

Së dyti: Sa i përket pretendimit se “Pajisja e ofertuar, duke qenë se mënyra e saj e karikimit është me AC power 2:4V70.75 rezulton në 1590 më e lirë se vlera e ofertës së shpallur fituese” KSHA si dhe KVO e cila ka refuzuar ofertën ka vepruar në bazë ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” Neni 2 pika d) dhe neni 3 pika 1 ku parashikohet qartë se:

-Qëllimi i këtij ligji është: të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”

1.Autoritetet dhe entet kontraktore “garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Ankimuesi me pretendimet e tij kërkon të vendosë ofertat në kushte jo të barabarta dhe duke ofruar një produkt të ndryshëm nga ai i kërkuar. Vlerësimi i ofertës si 15% më i lirë bëhet vetëm nëse produkti i plotëson specifikimet teknike, sa më sipër pretendimi nuk qëndron madje e ekspozon AK në veprime arbitrare.

Së treti: Sa i përket pretendimit se, “Skanerat objekt të procedurës se prokurimit janë për zyrat e reja të Identitek, ku në asnjë rast nuk mund të mungojë një furnizim AC me energji elektrike për çdo pajisje të mundshme zyre pasi sistemi i Identitek dhe çdo pajisje zyre qe Identitek përdor ka nevojë për burime energji për të operuar, apo burim energjie për tu lidhur me internet me sistemin qendror.”

4 KSHA ashtu siç jua kemi bërë të ditur në hyrje, ju sqaron se: zyrat që Identitek operon janë asete të trashëguara nga ish koncesionari ALEAT dhe kanë një infrastrukturë fizike, teknike dhe elektrike fikse. Sipas marrëveshjes koncesionare për 4 vite që ky sistem është brenda garancisë dhe kushteve të mirëmbajtjes së ish koncesionarit dhe nga ana jonë nuk mund të

bëhen ndryshime në infrastrukturë, në të kundërt do ekspozonim shoqërinë dhe shtetin Shqiptar në penaltete të pa përballueshme. Gjithashtu, nga ana teknike ju bëjmë me dije se sistemi jonë për të gjitha pajisjet TIK është me UPS dhe fuqia e instaluar është e përlogaritur për funksionimin për një kohë të parapërcaktuar për përfundimin e procesit të punës dhe fikjen e pajisjeve pa i dëmtuar ato, dhe nga ana jonë nuk mund të bëhen ndryshime ndaj dhe në specifikimet teknike parametrat e pajisjes kanë qenë minimale duke respektuar kriteret e AKSH-it pasi për infrastrukturën tonë elementi k është mënyra e furnizimit e cila nuk varet nga ne. Sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron për sa i përket trajtimit pasi numrit të furnizimit dhe ngarkesës së lejuar të cilën Ju nuk e përmendni, dhe mbi të gjitha JU keni bërë dhe një deklaratë (shtojca 8) pjesa IIIA: DEKLARATË Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës: ku deklaroni: “Ne cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nese kërkohet nga Autoriteti Enti Kontraktor), dhe marrim persiper të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e levrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor” Deklaratë e cila konsiderohet e rreme pasi JU nuk i plotësoni këto kritere, element të cilin e keni pranuar dhe në ankesë. Së katërti: Sa i përket pretendimeve se: “AK nuk ka si qellim furnizimin me skaner portable, pasi në këtë rast do të kishte përdorur edhe standartet TIK të përpiluar nga AKSHI për këtë tip pajisje por për një skaner zyre. -Ne një pajisje të tillë parametrat më të rëndësishëm, ato që ndikojnë drejt për së drejti në cilësinë e dokumenteve që do të skanohen janë karakteristikat teknike dhe jo menyrja e ushqimit. -AK ka kërkuar një skaner që të ketë si mënyrë karikimi ate DC-pra USB, por për një skaner zyre kjo nuk mund të jetë arsye për të përjashtuar çdo mënyrë tjetër karikimi. Pra, në këtë mënyrë edhe arsyeja e skualifikimit sonë me arsyetimin se skaneri i ofertuar nuk është ofertuar me power supply USB por me AC Power 24V 0.75A është jo i drejtë. -Oferta quhet e vlefshme sipas ligjit edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat. Për më tepër pajisja që ofrojmë është me shpejtësi skanimi më të lartë se çdo pajisje tjetër, 3 herë më e lartë se modeli i ofertuar.” -KSHA argumenton se: AK, KVO apo dhe KSHA në vlerësimin e ofertave i referuar pikës 3, neni 92, Kreu XI të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”. -Po ashtu, operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK ka patur hapësirën kohore dhe ligjore në dispozicion për të paraqitur kërkesat për sqarim ose ankesë në lidhje me dokumentet e tenderit pranë Autoritetit Kontraktor mbështetur në nenin 75, Kreu XI, pikën 1, neni 110, Kreu XIV të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik”, si dhe pikën 1, neni 97, Kreu XII të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), të cilën operatori ekonomik nuk e ka shfrytëzuar. Mos shfrytëzimi i kësaj hapësire kohore dhe ligjore interpretohet nga Autoriteti Kontraktor se operatori ekonomik është plotësisht i qartë me çfarë përmbajnë dokumentet e tenderit, i ka kuptuar dhe pranuar ato.



*Së pesti: KSHA, pasi analizoi pretendimet e ankimuesit dhe i verifikoi ato, ka krijuar bindjen e arsyeshme se asnjë nga pretendimet nuk qëndron nisur nga kushtet dhe infrastruktura c lidentitek sha. Gjithashtu, KSIIA për të arritur një siguri të arsyeshme u mbështet dhe në vendimin c KPP nr. 4972024 datë 12.01.2024 për një rast të ngjashëm në vlerësim dhe nga ana c anëtarëve të KPP bazuar në legjislacionin në fuqi është refuzuar ankesa c OE ankimues dhe dhënë e drejta AK për të vazhduar me hapat c mëtejshme të prokurimit.*

*Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK, nuk qëndron.*

*Referuar Kriterit kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 6, gërma “a” të Dokumentit të Specifikimeve Teknike (DST), është shprehur qartë se mospërputhja me specifikimet teknike të kërkuara përbën kusht skualifikues. Si rrjedhojë, duke qenë se pajisja e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara për pajisjen Skaner, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 114 të ligjit nr. 16272020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave*

#### VENDOSI:

- 1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, për procedurën e prokurimit, Loti 3 me objekt: “Skaner dhe MRZ Reader”, me fond të marrëveshjes kuadër: 7.550.000 lekë pa TVSH, me numër reference: REF-08245-06-05-2024.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”*

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “□ SKANER

- *Modeli i paraqitur, referuar katalogut, nuk ofrohet me ushqim “power supply”: USB, sic është kërkuar, por me “AC Power:*

*24V / 0.75A” duke mos plotësuar këtë kërkesë teknike të produktit.*

*Sa më sipër, për arsye të mospërbushjes së specifikimeve teknike si rrjedhojë e konstatimit të mangësive të mësipërme, bazuar në nenet 80 e 92 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 82 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2023*

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo oferte refuzohet.” KPP vëren se,*

III.1.2. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, Loti 3 “2.3 kapaciteti teknik” pika 2.3.3, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshura te prodhuesit, për objektin e prokurimi, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Katalogët/ broshurat të paraqiten ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit ditën e hapjes se ofertave dhe më pas të dorëzohen pranë AK përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimimit.*

III.1.3. Në Shtojcën 5 të dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, “Formulari i specifikimeve teknike”, për lotin 3 autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë vijon:

### **LOTI 3 “SKANER DHE MRZ READER”**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

**SKANER**

*cope*

**Sasia 100**

| <b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>                      |                                    |
|---|------------------------------------|
| <b>Tipi "Type":</b>   | <i>CCD ose CIS ose Ekuivalente</i> |
| <b>Formati "Format":</b>                                    | <i>A4</i>                          |
| <b>Rezolucioni Optikal "Optical Resolution":</b>            | <i>600 dpi</i>                     |
| <b>Thellësia e Grisë "Grayscale Depth":</b>                 | <i>16 bit</i>                      |
| <b>Thellësia e Ngjyrave "Color Depth":</b>                  | <i>48 bit</i>                      |
| <b>Mënyra e Skanimit "Scan Mode":</b>                       | <i>Single Pass</i>                 |
| <b>Vendosja e Materialit "Media Feeder</b>                  | <i>Flatbed</i>                     |
| <b>Ushqimi "Power Supply":</b>                              | <i>USB</i>                         |
| <b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>                           |                                    |
| <b>Porta e Komunikimit "Interface":</b>                     | <i>High-Speed USB 2.0</i>          |
| <b>Kompatibël me Sistemin e Operimit "Compatible O.S.":</b> | <i>Win. 10 ose më i ri</i>         |
| <b>"Drivers" + OCR Software:</b>                            | <i>Nuk Specifikohet</i>            |
| <b>AKSESORËT</b>  |                                    |
| <b>Ushqyes + Kabëll "Power Supply + Cord":</b>              | <i>Po, USB Cable</i>               |
| <b>CD/DVD Drivers and Software:</b>                         | <i>Po</i>                          |
| <b>Kabëll për Komunikimin e të Dhënave "Data Cable":</b>    | <i>(1) USB Cable</i>               |
| <b>GARANCIA</b>   |                                    |
| <b>Periudha e Mbulimit të Garancisë</b>                     | <i>1 Vit</i>                       |

## **MRZ READER**

*Sasia 10*

*cope*

| <b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>             |  |
|--|--|
| <b>Modeli:</b>                                     | <i>Lexues OCR &amp; MSR i kombinuar ne slotin e rrëshqitjes me dy drejtime</i> |
| <b>Modulet:</b>                                    | <i>Cip dhe RFID</i>  |
| <b>Certifikimet per OCR per zonën e lexueshme:</b> | <i>ISO/IEC 7501-1 dhe ICAO 9303</i>  |
| <b>Certifikimet per RFID:</b>                      | <i>ISO 14443 (A/B) dhe ICAO 9303</i>   |
| <b>Certifikimi per shiritin magnetik:</b>          | <i>ISO 7811</i>  |
| <b>Certifikimi cipit:</b>                          | <i>ISO 7816</i>  |
| <b>Certifikime te tjera:</b>                       | <i>IP54 per pluhurin dhe ujin</i>  |

### **INFORMACION:**

*Kompania Identitek zoteron sisteme dhe software "Proprietary" dhe te mbyllur per pajisjet e Aplikimit/ Shperndarjes se dokumenteve biometrike, te cilat jane te konfiguruar paraprakisht ne nje file konfigurimi xml te perpunuar nga Zhvilluesi i Aplikacionit. Modifikimet e mundshme jane te kufizuara, pasi nderhyrja ne nje komponent te aplikacionit mund te ndikoj ne hapat e tjera te procesit dhe deri ne deshtimin e ketij te fundit.*

*Ne stacionet aktuale te aplikimit/ shperdarjes që perdoren ne zyren e Kompanise IdentiTek jane te instaluar dhe konfiguruar modeli i skanerit Canon LiDE 400 dhe Epson Perfection V19.*

Per sa me sipër, eshte nevojshme qe pajisjet periferike qe do te ofertohej duhet te plotesojne domosdoshmerisht dhe kriteret funksionale si me poshtë listuar :

1. Kompatibiliteti me Konfiguracionin Proprietar te Sistemit aktual: skanerët e ofruar duhet te jene kompatibel me konfiguracionin e sistemit te mbyllur.
2. Aftesite per Integrim: Eshte nevojshme qe skanere mund te integrohen lehtesisht me sistemin proprietar pa kerkuar modifikime ose personalizime te zgjeruara. Ky integrim duhet te lejoje skanerët te komunikojne efektivisht me sistemin dhe te perdorin veçorite dhe funksionet e tij.
3. Testimi dhe Validimi: Per kete Autoriteti Kontraktor do te kerkoje qe OE te demonstrojne kompatibilitetin e skanerive te tyre me sistemin proprietar gjate procesit te tenderimit. Ky process do te perfshije ofrimin e konfigurimeve shembulli dhe testime te kompatibilitetit per te verifikuar integrimin pa problem.
4. Fleksibiliteti per Perditesime të Ardhshme: OE duhet te ofroje dhe siguroje që skaneret e zgjedhur te kanë fleksibilitet per te pranuar perditesime ose ndryshime te ardhshme ne konfiguracionin per tu pershtatus me sistemin e mbyllur te Autoritetit Kontraktor. Kjo mund te perfshije mbshtetjen per perditesime firmware, patch-e softuerike, ose ndryshime ne konfiguracion pa nderprere integrimin aktual.

Gjithashtu dhe pranimi I MRZ Readers do të jetë kusht të testohen dhe verifikohet kompatibiliteti me sistemin.

**SOARIM: Në lidhje me informacionin e sipërcituar, bëjmë me dije, se mostrat e kerkuara do te testohen duke filluar nga i pari ne klasifikim, per pershtatshmerine/perputhshmerine e tyre me sistemin qe IdentiTek disponon. Mosperputhja ose mospershtatja e pajisjeve me sistemin e IdentiTek eshte kusht skualifikues. Testimi i pajisjeve do te behet ne prezenc te operatorit.**

III.1.4. Në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve teknike më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogun e Plustek OpticSlim 2700 të shoqëruar me vërtetim njësie me origjinalin të datës 07.01.2023 dhe me nr. Rep 33 si dhe vërtetim përkthimi i datës 07.01.2023 me nr. REP 32.
- Dokumentin “Ofertë teknike” për lotin III të hartuar dhe nënshkruar nga vetë operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

- “1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.
2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.
3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:
  - a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;
  - b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;
  - c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.1.8. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.9. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.”.*

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.11. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik ankimes, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike për artikullin *skaner*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.4 të këtij vendimi.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes, si dhe nga pretendimet e e këtij të fundit, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, nuk i ka përmbushur specifikimet e mësipërme. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik e konkretisht katalogut të Plustek OpticSlim 2700 të përkthyer e të noterizuar, KPP vëren, se përmbajtja e tij nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për metodën e furnizimit me energji për pajisjen skaner. Referuar specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, furnizimi me energji për pajisjen skaner, duhet të kryhet përmes metodës “USB”, ndërsa në katalogun e Plustek OpticSlim 2700, metoda e furnizimit me energji është: AC Power: 24V/075 A, duke rënë në kundërshtim me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor për artikullin skaner. Sipas këtij konstatimi, katalogu i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes për përmbushjen e specifikimeve teknike, nuk

është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor lidhur me metodën e furnizimit me energji për këtë pajisje. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij, duke gjykuar që ankimuesi përveç katalogut më sipër, për plotësimin e specifikimeve teknike, ka paraqitur edhe dokumentin e firmosur dhe vulosur “Ofertë teknike loti III” me specifikimet teknike të pajisjes skaner Plustek OpticSlim 2700, specifikime teknike të hartuara, nënshkruara dhe vulosura nga operatori ekonomik ankimues. Në këtë dokument, ka të dhëna kontardiktore nga ato të përcaktuara në katalog për metodën e furnizimit me energji, pasi në dokumentin “ofertë teknike loti III”, metoda e furnizimit me energji është me USB, në ndryshim nga përcaktimi në katalog, i cili ka metodën AC Power: 24V/075 A. Gjithsesi, KPP në asnjë moment nuk mund të marrë në konsideratë deklaratimet e bëra nga vetë operatori ekonomik në dokumentin “Ofertë teknike loti III” për metodën e furnizimit me energji për pajisjen skaner, pasi në këtë dokument nuk verifikohet miratimi i prodhuesit lidhur me hartimin e specifikimeve teknike sipas dokumentit më sipër të ngarkuar në sistem. Akoma më tej, edhe vetë ankimuesi ka pranuar, që metoda e furnizimit me energji e paraqitur në katalog është e ndryshme nga ajo e përcaktuar në specifikime teknike, duke e konsideruar si një “devijim i vogël” dhe një mënyrë ekuiivalente të asaj të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se nuk jemi përpara ekuivalencës, pasi në kuptim të nenit 4 pika 7 të *lex specialis* “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit. Referuar sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK me katalogun e paraqitur në SPE për pajisjen skaner, për metodën e furnizimit me energji, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.2. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuara nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.



*Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

*Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]*

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kërkesë të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “BNT Electronics” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-08245-06-05-2024, me objekt: Loti 3 “Skaner dhe MRZ Reader”, me fond limit 7,550,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 26.06.2024, nga autoriteti kontraktor Identitek SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **K KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                      |                         |                    |                       |
|----------------------|-------------------------|--------------------|-----------------------|
| <b>Nënkryetar</b>    | <b>Anëtar</b>           | <b>Anëtar</b>      | <b>Anëtar</b>         |
| <b>Fiorent Zguro</b> | <b>Kreshnik Ternova</b> | <b>Anila Malaj</b> | <b>Gjergj Mersini</b> |

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

